



**Republika e Kosovës**



**Komuna e Vushtrrisë**

**Drejtoria për Arsim**

10 Nr. 912 /17

Datë: 23.11.2017

Bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenin 5. Pika c, të Ligjit nr. 03/L – 068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2015 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, dhe aprovimit nga Ministria e Financave Nr. 3606-1 dt.21.11.2017. Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri shpall këtë :

**KONKURS**

**Për vendet e lira të punës**

- **SHFMU”Enver Hadri” në Smrekonicë**  
*Një Mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane me kohë të caktuar në me plotësim norme në shkolla tjera.*
- **SHFMU ” Migjeni” Stanofc i epërm, lagjja Cakaj**  
*Një Mësues/e klase me kohë të caktuar*

**Kushtet për mësimdhënës :**

Për këto vende të punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm.

**Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim :**

- Formulari i aplikimit i cili merret në zyrën e arkivit Komunal
- Diploma (Certifikata e diplomimit jo më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e vërtetuar nga noteri
- Fotokopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi i përvojës së punës
- Vërtetimi nga gjykata se nuk është nën hetime
- Certifikatat e trajnimeve

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së shpalljes në shtyp, nga data 24.11.2017 deri me 08.12.2017. Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Intervistimi me shkrim i kandidatëve mbahet më 11.12.2017, në ora: 13:30 në sallën e Kuvendit Komunal.